



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan
D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,
trajtimin ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës

Tel/Fax: +355 4 2380 300/319
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot. Tiranë ___/___/2023
Nr. Dok. 202300199/1

Lënda: Rekomandohet përmirësimi i kushteve dhe i trajtimit të të huajve të parregullt akomoduar në Qendrën e Mbyllur për të Huajt Karreç.

Drejtuar: Z. Saimir BOSHNJAKU
Drejtor i Departamentit për Kufirin dhe Migracionin

Tiranë

Qendrës së Mbyllur për të Huajt

Karreç, Maminas Durrës

Për dijeni: Z. Muhamet RRUMBULLAKU
Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit

Tiranë

Të nderuar zotërinj,

Mekanizmi Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës (MKPT), në vijim "Mekanizmi Kombëtar", seksion pranë Avokatit të Popullit, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar dhe nenin 81 të ligjit nr.81/2020, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", zhvilloi një inspektim në Qendrën e Mbyllur për të Huajt në Karreç (QMHK). Inspektimi u krye në datën 17.02.2023, sipas planit vjetor të inspektimit, miratuar nga Avokati i Popullit. Grupi inspektues i MKPT-së përbëhej nga znj. Nertila Qafzezi, znj. Lindita Dedëgjoni dhe z. Hazbi Selita me detyrë nd/komisionerë pranë këtij Mekanizmi.

Objektivi kryesor i kësaj vizite monitoruese ishte vlerësimi i kushteve në Qendrën e Mbyllur për të Huajt në Karreç, mënyrat e trajtimit të shtetasve të huaj të parregullt të ndaluar, si dhe masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të parashtruara pas inspektimit të realizuar gjatë vitit 2022.

Nga ana e stafit të institucionit, ekspertët e grupit inspektues patën bashkëpunim të plotë duke u ofruar mundësia që të kishin akses brenda rregullave, të kontaktonin me gjithë personat dhe të vizitonin të gjitha ambientet që duhet të monitoronin.

Pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues, Avokati i Popullit ka detyrimin kushtetues dhe ligjor t'ju parashtrorjë konkluzionet përfundimtare, duke ju referuar si më poshtë vijon:

Shënime të përgjithshme

Qendra e Mbyllur për të Huajt, Karreç, është ngritur me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.1083, datë 28.10.2009 “Për ngritjen e Qendrës së Mbyllur dhe për miratimin e Rregullores së Organizimit dhe Funksionimit të saj” me qëllim strehimin e të huajve të parregullt në territorin e Republikës së Shqipërisë, ndaj të cilëve është marrë një masë ndalimi në përputhje me legjislacionin në fuqi, individë të ndaluar për kalim të paligjshëm kufiri, si edhe azilkërkues potencialë.

Qendra e mbyllur është një strukturë në varësi të Drejtorisë së Migracionit, pjesë e Departamentit për Kufirin dhe Migracionin, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Financimi i saj realizohet përmes buxhetit të shtetit.

Qendra e mbyllur është një institucion administrativ, me nivel të caktuar sigurie dhe kufizim lirie, në të cilin mund të akomodohen vetëm shtetasit e huaj që janë subjekt dëbimi nga territori i Republikës së Shqipërisë.

Kapaciteti zyrtar i kësaj Qendre është për 100 persona. Qendra e mbyllur kishte 25 dhoma për të mundësuar akomodimin e 4 personave për çdo dhomë. Në mjediset e institucionit në kohën e inspektimit ndodheshin 9 persona të gjithë meshkuj. Koha e qëndrimit të tyre në këtë Qendër varionte nga 1-12 muaj.

QMH Karreç ka një staf prej 37 punonjësish¹, nga këta 28 punonjës policie dhe 9 punonjës janë civilë në funksionet: Shef seksioni, specialist psikolog, kryeinfermier, kuzhinier, ndihmës kuzhinier, kujdestar magazinier, punonjës mirëmbajtje, sanitar.

Nga informacioni i grumbulluar në vend, nga kontakti me stafin e institucionit si dhe nga këqyrja e dokumentacionit, e objekteve dhe mjediseve, rezultoi se rekomandimet e lëna nga Avokati i Popullit pas inspektimeve të kryera në vitet 2021, 2022 nuk kanë gjetur zbatim dhe vazhdonin të ishin prezente problematikat si më poshtë²:

- Vazhdon problematika e mungesave në staf si: përkthyesi, mjeku, juristi, stomatologu mungesa të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në respektimin e të drejtave të personave të huaj të parregullt në Republikën e Shqipërisë.
- Në Qendër mungojnë aparatet kartofonike, të cilat janë të domosdoshme për personat e huaj, për të komunikuar me familjet. Grupi i inspektimit u informua nga stafi i institucionit se komunikimi i të akomoduarve me familjarët zgjidhej nëpërmjet qarkullimit të aparateve celular të personave, që i dispononin të cilët, me orar të caktuar ua jepnin personave të tjerë për të komunikuar me familjarët apo përfaqësuesit ligjorë.

¹ Miratuar me urdhër nr.328,të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, datë 30.03.2018, ndryshuar me urdhërin nr.665, datë 01.08.2020.

² Rekomandim dt. 16.06.2022, Nr.K4/I9-2 Prot. Rekomandohet përmirësimi i kushteve dhe trajtimit të të huajve të parregullt akomoduar në Qendrën e Mbyllur për të Huajt në Karreç.

- Vijon problematika e mungesës në Qendër të përkthyesit, si një nevojë emergjente për komunikimet të cilët duhet të jenë për gjuhën angleze ose të gjuhës së huaj dominante të të huajve që ndodhen të akomoduar në këtë Qendër. Kjo mungesë sillte në vazhdimësi, vështirësi në komunikimin dhe ndërveprimin e të akomoduarve me punonjësit e Qendrës.
- Mungojnë aktivitetet kulturore, argëtuese e sportive.
- Në të gjitha ambientet e Qendrës ishte evidente mungesa e posterave me të drejtat ligjore të shtetasve të huaj të parregullt të ndaluar.
- Nuk ishte kryer lysterja periodike e dhomave të fjetjes së personave të huaj të akomoduar në Qendër, sidomos në korridorin e përbashkët të dhomave të banimit vërehej një ambient i papastër, mure të palyera dhe aromë e pakëndshme.
- Në Qendër nuk ofrohet shërbimi stomatologjik.
- Qendra ka vetëm një infermier i cili ju përgjigjet nevojave dhe shërbimit mjekësor.
- Mungonin zilet e emergjencës në dhomat e fjetjes.
- Lagështira ishte prezentë pothuajse në të gjitha ambientet e qendrës, ku në ditët me shi vendosen kova për pritjen e ujit që kullon nga tavanet e dëmtuar.
- Dollapët dhe dyert në të gjitha ambientet kishin nevojë për riparime.

Rekomandimet e Avokati të Popullit për vitin 2022 të pazbatuara:

1. Marrjen e masave të menjëhershme për investime në izolimin e tarracës së institucionit për eliminimin e lagështirës të theksuar në çdo ambient të qendrës.
2. Marrjen e masave të nevojshme për shtimin e stafit të kësaj Qendre me 1 punonjës social, edukator, 1 jurist part time, 1 stomatolog part time, 1 përkthyes fillimisht part-time e më pas në varësi të kapaciteteve me kohë të plotë, me qëllim respektimin e të drejtave të të huajve të parregullt në Republikën e Shqipërisë.
3. Marrjen e masave të menjëhershme për të parashikuar një mjek dhe një stomatolog në organikën e sektorit shëndetësor në mënyrë që në institucion të ofrohet një shërbim shëndetësor i plotë dhe efikas.
4. Marrjen e masave të menjëhershme për përmirësimin e cilësisë dhe shumëllojshmërisë të ushqimit për të huajt e ndaluar, që janë akomoduar në Qendrën e Mbyllur për të Huajt në Karreç.
5. Marrjen e masave të menjëhershme për të siguruar pyetjen e personave të privuar nga liria nga autoritetet përkatëse me praninë e një përkthyesi në gjuhën amtare të tyre për të garantuar të drejtat themelore.
6. Marrjen e masave për lysterjen e godinës, brenda dhe jashtë për arsye të dezinfektimit.

7. Marrjen e masave të menjëhershme për të garantuar ngrohjen në ambientet e banimit për personave të huaj të akomoduar në qendër.
8. Marrjen e masave të menjëhershme për lejimin e personave të huaj të akomoduar në qendër për procesin e ajrimit në ambientin e jashtëm të qendrës.
9. Marrjen e masave për të krijuar ambiente rekreative në hapësirën e jashtme të Qendrës me pajisjet e nevojshme për aktivitete sportive.
10. Marrjen e masave për vënien në funksionim të sistemimit të njoftimit me zilet e emergjencës në dhomat e fjetjes të të huajve dhe instalimin e këtij sistemi në dhomat e veçimit.
11. Marrjen e masave për të realizuar investime për përmirësime në sistemet hidrosanitare dhe ato elektrike.
12. Marrjen e masave për të pajisur ambientet e kësaj Qendre me aparate kartofonike, sikurse është parashikuar në rregulloren e institucionit.
13. Marrjen e masave të menjëhershme për të vënë në dispozicion të personave të privuar nga liria të dokumentacionit gjithëpërfshirës, për aksesin në të drejtat dhe rregullat e jetës në këtë Qendër në një gjuhë të kuptueshme për të gjithë, gjithashtu dhe të përmirësohet shpërndarja e informacionit për azilkërkuesit dhe grupet vulnerabël.
14. Marrjen e masave për pasurimin e bibliotekës me literaturë dhe akte juridike në gjuhë të huaj.
15. Marrjen e masave të nevojshme për vendosjen në ambientet e qendrës të posterave, me të drejtat ligjore të shtetasve të huaj të ndaluar, në gjuhë të ndryshme.

Rekomandimet që ishin zbatuar pjesërisht:

1. Ishin marrë masa për furnizimin e institucionit me ilaçe të urgjencës dhe ilaçe për sëmundjet kronike.
2. Ishte pasuruar biblioteka me literaturë dhe akte juridike në gjuhë të huaj.

Trajtimi

Gjatë vizitës monitoruese, grupi inspektues pati si objekt të punës së tij mbledhjen e informacionit lidhur me trajtimin e të huajve të strehuar në këtë Qendër, si dhe identifikimin e rasteve të përdorimit të presionit psikologjik, të dhunës fizike, apo të ushtrimit të forcës tej kufijve të parashikuar nga aktet normative në fuqi ndaj kësaj kategorie. Grupi inspektues u takua me personat e huaj që ndodheshin në këtë Qendër dhe bisedoi me ta në mënyrë konfidenciale dhe pa praninë e stafit.

Nga intervistimet janë ngritur problematikat si më poshtë:

- Mungesa e një përkthyesi në Qendër vështirësonte komunikimin e tyre me punonjësit e institucionit.
- Nevoja për konsultime me jurist në lidhje me paqartësitë që kishin në lidhje me statusin e tyre.
- Problematika e pamjaftueshmërisë së ushqimit.
- Mungesa e higjienës, ambientet e ftohta të banimit për periudhën e dimrit.
- Mungesa e aktiviteteve në Qendër.

Nga intervistat nuk rezultoi që ndaj tyre të ishte ushtruar dhunë fizike apo psikologjike nga ana e punonjësve të Policisë së Shtetit, apo nga personeli civil që shërbente në këtë Qendër.

Megjithatë u verifikuan edhe regjistrat përkatës të institucionit, ku u konstatua se nuk figuronte e regjistruar ndonjë ngjarje, ankesë apo pretendim dhune, po ashtu u pyetën të 9 personat e akomoduar në Qendër, prej të cilëve nuk u referuan raste keqtrajtimi.

Libri në të cilin pasqyrohen rastet e përdorimit të forcës administrohet nga salla operative. Për çdo lloj problemi që mund të kenë shtetasit e huaj, ata mund të kërkojnë takim me specialistin e intervistimit, shefin e sigurisë dhe drejtorin e Qendrës (dhe me përgjegjësin e shërbimit jashtë orarit zyrtar), nga verifikimi i regjistrave ende nuk kishte të regjistruar asnjë ankesë, kjo për shkak se të gjithë personat e kishin të pamundur të komunikonin me stafin në mënyrë shteruese, theksojmë se edhe nevojat apo kërkesat i komunikonin me stafin e Qendrës me shenja, por edhe me disa fjalë në shqip apo anglisht.

Komunikimi i tyre me botën e jashtme përmes aparateve kartofonike ende nuk ishte mundësuar.

Ankesa pati në disa raste edhe për trajtimin ushqimor, nga verifikimi i menysë javore në kuzhinë u konstatua se ajo nuk ishte e larmishme. Nga punonjësi i kuzhinës grupi u informua se trajtimi me ushqim i të huajve bëhej në bazë të normativave të miratuara nga Ministri i Punëve të Brendshme dhe Ministri i Shëndetësisë dhe Urdhrit të DPP-së nr.5784, datë 15.11.2017, “Për miratimin e normave të trajtimit me ushqim”. Norma ushqimore përcaktohej në ushqim ditor sasi/kalori. Sipas stafit të institucionit ushqimi që sigurohet nga subjekti kontraktues kontrollohet në institucion nga komisioni i pritjes.

Sipas tij, numri i ndryshueshëm i shtetasve të trajtuar në Qendër e vështirëson gatimin me sasinë e parashikuar të asortimenteve për kuotë.

Gjithashtu ankesa u paraqitën edhe përsa i takon kohës së qëndrimit në këtë institucion pasi nga autoritetet nuk u është dhënë informacion, për kohën dhe për arsyet që do mbahen të privuar nga liria, ***mungesa e një juristi në qendër shtonte tek këta persona, pasigurinë dhe paqartësinë mbi statusin e tyre dhe kohën e qëndrimit në qendër.*** Ankesat kryesore që u administruan nga pothuajse të gjithë shtetasit e huaj ishte e lidhur me ndihmën juridike dhe njohjen e kushteve të tyre.

Disa persona paraqitën pretendimin se edhe pyetja e tyre nga autoritetet shqiptare (*nga prokurorë ose oficerë të policisë gjyqësore*) **në disa raste bëhet pa praninë e përkthyesve të gjuhës arabe dhe duke përdoruar ato pak njohuri gjuhësore të gjuhës angleze.**

Po ashtu, u administruan edhe ankesa dhe pretendime lidhur me shërbimin shëndetësor që ofrohet në këtë Qendër ka vetëm një infermier. ***Gjithashtu u konstatua se shërbimi stomatologjik vazhdonte të mungonte tërësisht në këtë qendër.*** Në rastet kur kishte shqetësime shëndetësore nga të huajt e akomoduar në qendër ata dërgoheshin për konsultë në spitalin rajonal të qytetit të Durrësit, gjithashtu edhe për nevojat stomatologjike ata dërgoheshin në klinikat më të afërta dhe pagesa ndaj këtij shërbimi kryhej nga vetë të huajt. Këto vizita pasqyroheshin në regjistrin e vizitave mjekësore i cili administrohej nga infermieri i qendrës. Këto problematika janë shqetësuese përderisa kjo qendër është e mbyllur dhe personave të akomoduar në të ju ndalohej dalja prej saj.

Masat mbrojtëse

Në bazë të VKM nr.1083 datë 28.10.2009 “*Për ngritjen e Qendrës së Mbyllur dhe për miratimin e Rregullores së Organizimit dhe Funksionimit të saj*” dhe Rregullores së Brendshme të Qendrës, miratuar me Urdhrin Nr.117, datë 09.02.2010, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, të huajt e ndaluar dhe akomoduar në këtë Qendër kanë të drejtën të përfitojnë asistencë individuale mjekësore, ligjore e sociale.

Nga inspektimi u konstatua **se shërbimi shëndetësor, psiko-social dhe ligjor kishin mangësi të theksuara dhe për rrjedhojë cenoheshin standardet e trajtimit të kësaj kategorie.**

Rekomandim i Komiteti për Parandalimin e Torturës (KPT) i Këshillit të Evropës rekomandon që autoritetet shqiptare të ndërmarrin hapat e nevojshme për t`u siguruar që në Qendrën pritëse e Mbyllur për të Huajt (QMH), Karreç³:

Në institucion vazhdonte të mungonte pozicioni i juristit, funksioni i të cilit është i domosdoshëm për të përmbushur nevojat për shërbim ligjor ndaj personave që mbahen të privuar nga liria si dhe paralelisht nevojat institucionale të parashikuara në pjesën e pestë të VKM-së nr.1083 datë 28.10.2009 nr.1083 datë 28.10.2009. Këto funksione sipas informacionit të dhënë në ditën e monitorimit, kryheshin nga punonjësit e tjerë të Qendrës dhe nga stafi drejtues.

Materialet informuese me të drejtat e personave të huaj të ndaluar, mungonin në të gjithë ambientet, ato duhet të jenë në gjuhë të ndryshme, që mund të kuptohen nga të huajt të cilët vijnë nga vende të ndryshme.

Sistemi i pritjes dhe i kontrollit fizik për pritjen dhe intervistimin e të huajve kryhej konform rregullores së përgjithshme dhe asaj të brendshme.

³ shih: <https://rm.coe.int/168097986b>. “Report to the Albanian Government on the visit to Albania carried out by the European Committee for the Prevention of Torture and Inhuman or Degrading Treatment or Punishment (CPT)” from 20 to 30 November 2018 CPT/Inf(2019).

Nga monitorimi në Qendër u konstatua se për të gjithë të huajt e ndaluar dhe të akomoduar **mungonin dosjet personale të cilat duhet të administrohen nga sektori social** të cilat duhet të pasqyrojnë në mënyrë periodike të gjitha takimet dhe trajtimet psikologjike me personat e akomoduar në qendër siç janë, këshillimet individuale dhe këshillimet në grup si dhe vlerësimi psikologjik i çdo peroni të huaj që akomodohet rishtas në qendër.

Regjistrat fizikë në Qendër janë: Regjistri i pranimeve, regjistri i takimeve avokat/familjar etj, regjistri i hyrje/daljeve, regjistri i ankesave, regjistri i marrjes-dorëzimit të shërbimit, si dhe procesverbalet për marrjen në dorëzim të sendeve personale dhe të vlerave monetare.

Ambienti ku depozitoheshin vlerat monetare dhe sendet personale funksiononte sipas Rregullores. Nga verifikimi dhe inspektimi i dokumentacionit nuk u konstatuan parregullsi. Të gjitha veprimet që kryheshin me të huajt lidhur me sendet personale dhe vlerat monetare regjistroheshin në regjistrin përkatës.

Lidhur me çështjen e sigurisë, Qendra ishte e pajisur me kamera vëzhgimi, si në mjediset e jashtme ashtu dhe në ambientet e brendshme. Nga informacioni i marrë nga shefi i sigurisë por dhe verifikimi në Qendër rezultoi se sistemi i monitorimit funksiononte.

U konstatua se zilet e emergjencës në dhomat e fjetjes të të huajve, nuk funksiononin ndonëse Institucioni i Avokatit të Popullit ka rekomanduar disa herë, se kjo është një domosdoshmëri për rastet emergjente.

Në këtë Qendër kishte katër ambiente veçimi, të cilat ishin me kubaturë dhe hapësirë të mjaftueshme, dritare me përmasa të cilat lejojnë ajrosjen dhe futjen e dritës natyrale. Tualetet në këto ambiente ishin me lagështirë.

Nga kontrolli i regjistrit përkatës u evidentua se masat e sigurisë “me izolim” jepeshin nga drejtori i Qendrës. Zakonisht masat e sigurisë ishin dhënë në pak raste dhe jo më tepër se një ditë shoqëruar me shpjegimet përkatëse. Dyert e dhomave të veçimit ishin prej hekuri dhe të një formati burgu dhe jo të një Qendre pritëse. Dhomat e izolimit **nuk ishin të pajisura me sistem alarmi**, që i jep mundësi personit të izoluar të njoftojë një anëtar të personelit sipas rregullores “Masat e Sigurisë” Kreu IV, neni 7.

Për të huajt gra dhe të miturit, kishte një sektor të veçantë, i cili ishte i ndarë nga sektori i burrave. Aktualisht në të këtë sektor nuk ndodhej asnjë person i huaj i akomoduar aty. Nga drejtuesi i institucionit na u sqarua se në rastet kur të huajt e strehuar ishin me familjet, ata akomodoheshin së bashku.

Lidhur me funksionimin e sistemit të kërkesë/ankesave, kjo qendër dispononte një regjistër ku pasqyroheshin kërkesat dhe ankesat e të huajve. Regjistri përmbante rubrika të specifikuar mbi ankesën dhe zgjidhjen e saj dhe i referoheshin punonjësës sociale apo punonjësit të sigurisë, të cilët merrnin masa për të njoftuar drejtorin e institucionit dhe zgjidhjen e menjëhershme të ankesës.

Vizitat nga avokatët, përfaqësuesit diplomatikë etj, kryheshin sipas parashikimeve në Rregullore dhe regjistroheshin në regjistrin përkatës.

Kushtet materiale

Kjo Qendër përbëhej nga një godinë dy katëshe, me një pjesë të parashikuar për zyra administrative dhe pjesa tjetër për regjimin me 25 dhoma akomodimi, 4 dhoma veçimi, bibliotekë, lavanteri, dushe, ambient rekreacioni, magazina dhe ambiente ajrosje të jashtme.

Nga këqyrja e këtyre ambienteve konstatoam se situata e kushteve materiale ishte përkeqësuar dukshëm nga inspektimi i një viti më parë: Sektori i katit të parë **paraqiste probleme të theksuara të lagështirës, kushteve sanitare dhe materiale**. Grupi i inspektimit vizitoi dhe dhomat e banimit, po në këtë kat të cilat kishin një prezencë të theksuar lagështire. Tavanet e korridoreve në këto ambiente rridhnin ujë dhe ishin vendosur kova pritëse për të grumbulluar ujin që kullonte në dysHEME.

Dhomat e banimit në katin e parë ishin të pajisura me materiale bazë si batanije, jastëk por ato dukshëm ishin të konsumuara, brenda të gjitha dhomave të banimit kishte tualete. Ndërkohë ambientet e dhomave të fjetjes ishin të palyera dhe me një mungesë të theksuar higjiene. Prezenca e lagështirës ishte një nga shqetësimet kryesore nga personat e huaj të akomoduar në qendër. Lidhur me këtë shqetësim në bashkëbisedim me stafin e institucionit na u bë me dije se nga ana e tyre janë bërë kërkesa të vazhdueshme institucioneve eprore përgjegjëse, **se ishte i nevojshëm izolimi i tarracës për të evituar lagështirën e theksuar**.

Dhomat ishin të pajisura me shtretër dhe dollapë. Dhomat ishin të parashikuara për 2 deri në 4 persona. Ato kishin dritare me përmasa të tilla që lejonin ajrosjen dhe futjen e dritës natyrale. Gjithashtu dhomat ishin të pajisura edhe me ndriçim artificial. Nuk u konstatua prania e insekteve apo brejtësve.

Në rastet e mungesës së energjisë elektrike nga rrjeti, ndriçimi artificial sigurohej nga një gjenerator. Ngrohja e ambienteve të Qendrës, realizohej nga sistemi i ngrohjes me kaldajë, i cili vihej në punë nga data 15 nëntor deri në 15 mars. Megjithatë nga biseda me personat e huaj që ndodheshin të akomoduar në qendër ata u shprehën e ambienti i dhomave ishte i ftohtë dhe kaldaja ndizej rrallë nga ana e administratës së qendrës. Për ruajtjen e higjiens personale jepeshin detergjente, si sapun dhe ilaç rrobash. Larjet e trupit bëheshin me grafik, në 2 dushtet e përbashkëta, të cilat ishin të pajisura me bojlerë për të mundësuar ujin e ngrohtë, lavanteria ishte e pajisur me një lavatriçe që shërbente për larjen e rrobave.

Në qendër ishte mjedis ambulator dhoma e infermierit, në të cilën ndodheshin medikamentet e emergjencës si dhe për personat e sëmurë kronik.

Sipas stafit, ambienti i ajrimit përdorej për lojëra sportive, por fusha ishte e papërshtatshme për zhvillimin e lojërave me top. Nga biseda me personat e huaj konstatoam se aktivitetet në qendër ishin pothuajse inekzistente.

Biblioteka e qendrës, kishte literaturë fetare, me botime në gjuhën arabe, si dhe në literaturë juridike. Në Qendër kishte një ambient kulti, si dhe kishte një ambient faljeje për besimtarët.

Kuzhina dhe mensa kishte tavolina dhe karrige të mjaftueshme në përputhje me kapacitetin e numrit të personave që akomodoheshin në qendër.

Njësia tregtare për të mundësuar blerje të artikujve të ndryshëm nga personat e strehuar në të vazhdonte të ishte në mungesë. Në rast nevojë, artikujt siguroheshin nga punonjësit e institucionit, të cilat i blinin jashtë ambientit të qendrës, sa herë që ata kishin nevojë nëpërmjet shitësve ambulatorë të zonës.

Aktivitetet

Grupi inspektues konstatoi se ajrimi i të ndaluarve dhe zhvillimi i aktiviteteve argëtuese e sportive nuk bëhej sipas rregulloreve në fuqi. Sikurse u verifikua nga bisedat me personat e ndaluar në Qendër, si dhe nga bisedat me pjesëtarë të stafit, të huajt nuk bënë ajrim të jashtëm, dhe lejoheshin të qëndronin vetëm në ambientin e brendshëm të institucionit për ajrim.

Sipas organikës së miratuar, Qendra kishte vetëm specialistë për pranim dhe intervistim, por nuk kishte pozicione pune të tilla **si edukatorë dhe jurist**, tepër të rëndësishme për natyrën e funksionimit të saj.

Duke marrë në konsideratë faktin se në këtë Qendër vijnë persona me trauma të tipeve të ndryshme, familje të shpërngulura nga vende në gjendje lufte etj, grupi i inspektimit konkludoi se stafi psiko-social duhet të jetë konform parashikimeve ligjore në Rregulloren për Qendrën e Mbyllur për të Huajt, respektivisht në Pjesën e Pestë, Kreu III **“Asistenca sociale, koha e lirë dhe zhvillimi i përgjithshëm”**, nenet 1 dhe 2, për të plotësuar të gjitha nevojat e shtetasve të huaj në aspektin psiko-social dhe përmirësimit të gjendjes së tyre psikologjike gjatë qëndrimit të tyre në këtë Qendër. Në qendër mungonin aktivitetet dhe nuk kishte asnjë planifikim për aftësim apo për mësimin e gjuhës.

Shërbimi shëndetësor

Në organikën e Qendrës së mbyllur nuk kishte mjek, por vetëm një infermier. Gjithashtu nuk kishte as stomatolog, në rast nevojë, të huajt dërgoheshin tek stomatolog privat.

Infermieri kryente vizitat e të gjithë personave, që në momentet e para, sapo ata akomodoheshin në këtë Qendër dhe në mënyrë periodike në vijimësi, por kjo ishte e pamjaftueshme. Duke marrë në konsideratë se herë pas here këta persona shfaqin problematika, nevoja për mjek në Qendër është e domosdoshme të paktën part- time.

Sipas informacionit të marrë nga shefi i sigurisë na informoi se në rastet kur kërkoheshin ekzaminime të specializuara apo të sëmundjeve infektive, të huajt dërgoheshin në Spitalin Rajonal Durrës, apo trajtoheshin nga Sektori i Higjienës, pranë Drejtorisë së Shëndetit Publik Durrës. Institucioni **nuk kishte një autoambulancë**. Në rastet emergjente përdoreshin makinat e Qendrës për transportimin e të huajve pranë qendrave spitalore.

Në përfundim të inspektimit, **Institucioni i Avokatit të Popullit shpreh me shqetësim që gjendja e përgjithshme në qendër është përkeqësuar.**

Për sa më sipër dhe në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata*

publike”; të nenit 21, gërma “b” të ligjit nr. 8454 datë. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive; si dhe në bazë të nenit 74/1 pika “b” të ligjit nr. 9888 datë 10.03.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8328 datë 16.04.1998, Për të drejtat dhe trajtimin e të paraburgosurve dhe të dënuarve me burgim” ku midis të tjerash parashikohet se: “Avokati i Popullit nëpërmjet Mekanizmit Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimin ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues ka këto kompetenca:

b) paraqet rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohet trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura dhe trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor dhe poshtërues”,

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave të menjëhershme për investime në izolimin e tarracës së institucionit për eliminimin e lagështirës të theksuar në çdo ambient të qendrës.
2. Marrjen e masave të nevojshme për shtimin e stafit të kësaj Qendre me 1 punonjës social, edukator, 1 jurist part- time, 1 stomatolog part- time, 1 përkthyes fillimisht part- time e më pas në varësi të kapaciteteve me kohë të plotë, me qëllim respektimin e të drejtave të të huajve të parregullt në Republikën e Shqipërisë.
3. Marrjen e masave të menjëhershme për të parashikuar një mjek part-time dhe një stomatolog në organikën e sektorit shëndetësor në mënyrë që në institucion të ofrohet një shërbim shëndetësor i plotë dhe efikas.
4. Marrjen e masave të menjëhershme për përmirësimin e cilësisë dhe shumëllojshmërisë të ushqimit si dhe rritjen e kuotës së ushqimit për të huajt e ndaluar, që janë akomoduar në Qendrën e Mbyllur për të Huajt në Karreç.
5. Marrjen e masave të menjëhershme për të siguruar pyetjen e personave të privuar nga liria nga autoritetet përkatëse me praninë e një përkthyesi në gjuhën amtare të tyre për të garantuar të drejtat themelore.
6. Marrjen e masave për lyerjen e godinës, brenda dhe jashtë për arsye të dezinfektimit.
7. Marrjen e masave të menjëhershme për të garantuar ngrohjen në ambientet e banimit për personave të huaj të akomoduar në qendër.
8. Marrjen e masave të menjëhershme për lejimin e personave të huaj të akomoduar në qendër për procesin e ajrimit në ambientin e jashtëm të qendrës.

9. Marrjen e masave për vënien në funksionim të sistemimit të njoftimit me zilet e emergjencës në dhomat e fjetjes të të huajve dhe instalimin e këtij sistemi në dhomat e veçimit.
10. Marrjen e masave për të realizuar investime për përmirësime në sistemet hidrosanitare dhe ato elektrike.
11. Marrjen e masave për të pajisur ambientet e kësaj Qendre me aparate kartofonike, sikurse është parashikuar në rregulloren e institucionit.
12. Marrjen e masave të menjëhershme për të vënë në dispozicion të personave të privuar nga liria të dokumentacionit gjithëpërfshirës, për aksesin në të drejtat dhe rregullat e jetës në këtë Qendër në një gjuhë të kuptueshme për të gjithë, gjithashtu dhe të përmirësohet shpërndarja e informacionit për azilkërkuesit dhe grupet vulnerabël.
13. Marrjen e masave të nevojshme për vendosjen në ambientet e qendrës të posterave, me të drejtat ligjore të shtetasve të huaj të ndaluar, në gjuhë të ndryshme.
14. Marrjen e masave nga stafi psiko-social për hapjen e dosjeve ndaj çdo personi të huaj të akomoduar në qendër në të cilat të evidentohen trajtimit dhe këshillimet psikologjike ndaj tyre si dhe aktivitetet të zhvilluara ditore dhe mujore .

Për qëndrimin që do të mbaj institucioni, si dhe dhe masat që do të marrin në zbatim të këtyre rekomandimeve, duhet që të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

KOMISIONER

AHMET PRENÇI